



SHOQATA EMDR ALBANIA

WWW.EMDRALBANIA.ORG



EMDR Albania është një shoqatë e themeluar në Shqipëri në vitin 2016. Shoqata u themelua për të përmbushur dy qëllime kryesore: së pari, mbështetjen psikologjike të individëve me probleme të shëndetit mendor dhe së dyti, formimin e profesionistëve të shëndetit mendor në terapinë EMDR. EMDR Albania u krijua për të sjellë një model evropian shërbimesh ndaj individëve dhe komunitetit, me standard të larta etike dhe integritet profesional. Stafi i shoqatës përfshin profesionistë, me kompetenca dhe eksperiencë profesionale, të përvetësuar ndër vite me persona në nevojë. Anëtarët e shoqatës u përkasin të gjitha krahinave shqip folëse në Ballkan (Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni).

Shoqata EMDR Albania synon të arrijë këto objektiva:

- Formim teorik dhe praktik në terapinë EMDR të profesionistëve të shëndetit mendor (psikologë, psikoterapistë, punonjës socialë, mjekë, etj.).
- Formim teorik dhe praktik të profesionistëve të fushës në çështjet dhe shqetësimet e lidhura me shëndetin mendor.
- Këshillim, psikoterapi, terapi dhe mbështetje psikosociale dhe ligjore për individët me shqetësime të shëndetit mendor.
- Këshillim, terapi dhe mbështetje falas për individët në kushte të vështira ekonomike.
- Nxitje dhe promovim të shëndetit mendor në nivel individual dhe komunitar.
- Bashkëpunim me disiplina të tjera akademike dhe të shëndetit, në dobi të shëndetit mendor.
- Bashkëpunimin vullnetar me institucionet shtetërore në periudha krize dhe emergjence, duke ofruar ndërhyrje të specializuara.

Shëndeti mendor është një e drejtë universale që duhet t'a gëzojnë të gjithë, pavarësisht nivelit socio-ekonomik të individëve. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të trajtohen, ndaj EMDR Albania, si pjesë e EMDR Europe, nuk mund të heshtë përballë situatave të vështira që kalojnë qytetarët shqiptarë, të cilët shpesh nuk menaxhohen nga asnjë institucion lokal. Prandaj, shoqata jonë ofron këshillim psikologjik dhe ligjor falas në

raste krizash dhe emergjencash. Shpresojmë që stafi ynë të rritet dita-ditës me profesionistë të fushave të ndryshme, për të arritur një shërbim të përshtatshëm për individët në nevojë.

Ku mund t'a gjej terapistin në qytetin ku jetoj?

Për rekomandime mund të kontaktoni Bordin Emdr Albania ose të konsultoni listën e terapistëve në web site:

www.emdralbania.org

**Për të përfituar çertifikaten e
PRACTITIONER IN EMDR THERAPY
mund të kontaktoni supervizoren për t'u bërë pjesë e një grupi në
supervizim, kujdes: mund të supervizionohesh vetëm nëse je Anëtar!**

Kohëzgjatja e anëtarësimit vlen nga data 1 janar-31dhjetor.

Student 50€	Profesioniste 80€	Terapiste Emdr 80€
-20% Trajnime 2 ditore (nga 100/ne 80€)	-20% Trajnime 2 ditore(nga 100/ne 80€)	-20% Trajnime 2 ditore(nga 100/ne 80€)
-Ulje Seminare/ Workshope (nga 20/ne 15€)	-20% Seminare/ Workshope(nga 20/ne 15€)	-20% Seminare/ Workshope(nga 20/ne 15€)
2 takime ne Grup me Profesionistet	Promovim ne rrjetet sociale	Promovim ne rrjetet sociale
Revista (1 numer falas)	Revista (1 numer falas)	Revista (2 numra falas)
	Supervizim ne Grup 30 € ora	Supervizim ne Grup 30€ ora
	Bookclub (10€)	Bookclub (falas)

EMDR ALBANIA

NUMRI I LLOGARISË 411003026

IBAN EURO AL3120511117003026CLTJCFEURV

BANKA KOMBËTARE TREGTARE